



Monitorimi për muajin tetor 2017 nga ndjekja e Kapitullit 23 – gjqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore

I Gjyqësori

Reformat e gjyqësorit

Takimi i ministrit të drejtësisë Saliji me euroambasadorin Zhbogar

Më 19 tetor 2017 Ministri i drejtësisë, Bilen Saliji, u takua me euroambasadorin Samuel Zhbogar dhe Ministrin e punëve të jashtme të Republikës së Maqedonisë, Nikolla Popovski. Në këtë takim u bisedua për ndërmarrjen e aktivitetëve dhe statusin e realizimit të obligimeve të cilat i ka ndërmarrë Ministria e Drejtësi në lidhje me plotësimin e reformave të parapara në gjyqësor sipas planit “3-6-9” të Qeverisë së RM-së, duke përfshirë edhe finalizimin e tekstit të Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit përgatitja e të cilës përfshiu shqyrtimin e propozimeve të marra nga të gjitha palët e prekura. Ambasadori Zhbogar e theksoi rëndësinë e këtij dokumenti strategjik dhe dha mbështetje për të gjitha obligimet të cilat i ka Ministria e Drejtësisë në lidhje me krijimin e kushteve për lehtësim të procesit të eurointegritimeve.¹

Mbikëqyrje publike në propozim-normativën juridike dhe shpalljen e saj në RVEN

Ministria e Drejtësisë tekstet juridike të Propozim-ligjit për Shfuqizim të Ligjit për Këshillin për Përcaktim të Fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktim të përgjegjësisë për gjykatësit² dhe Propozim-ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor³ i vendosi në mbikëqyrje publike nëpërmjet ueb-faqes së saj zyrtare.⁴

Nga mbikëqyrja në Regjistrin e Vetëm Elektronik Nacional të normativës (REVN), duke filluar nga korriku i vitit 2017 është zmadhuar theksueshëm azhurnimi, nëpërmjet lajmërimeve për publikun ekspert dhe më të gjerë, i propozim-normativës ligjore më të re në kompetencë të institucioneve të ndryshme

¹http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1398

²<http://www.pravda.gov.mk/documents/%CF%D0%C5%C4%CB%CE%C3%20%CD%0%20%20%07%0%CA%CE%CD%20%07%0%20%CF%D0%C5%D1%D2%0%CD%CE%CA%20%CD%0%20%02%0%06%05%8C%05%D2%CE%20%CD%0%20%07%0%CA%CE%CD%CE%D2%07%0%20%D1%CE%02%05%D2%CE%D2%20%07%0%20%D3%D2%02%D0%04%D3%02%08%05%20%CD%0%20%D4%0%CA%D2%08.pdf>

³<http://www.pravda.gov.mk/documents/%CF%D0%C5%C4%CB%CE%C3%20%CD%0%20%20%07%0%CA%CE%CD%20%07%0%20%20%D1%D3%04%D1%CA%08%20%D1%CE%02%05%D2.pdf>

⁴http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1396



shtetërore, duke e përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë. Gjatë tetorit në RVEN janë shpallur Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, Propozim-ligji për Këshillin për përcaktim të fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktim të përgjegjësisë për gjykatësin, Propozim-ligji për ndihmë juridike pa pagesë, si dhe Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Gjykatat. Të gjitha këto projekt-ligje janë pjesë e “Planit 3-6-9” dhe e Strategjisë për reforma në sistemin gjyqësor që sapo është përcaktuar dhe përgatitja e të cilës është në fazën përfundimtare.

Pavarësia

Kryetarët e Gjykatës së Lartë dhe të Këshillit Gjyqësor në vizita të veçanta në Gjykatën Themelore Gjevgjeli

Kryetari i Gjykatës së Lartë, Jovo Vangelovski së bashku me udhëheqësin e Shërbimit informatik në gjykatë e vizitoi Gjykatën Themelore në Gjevgjeli, me qëllim që të kryejë kontroll të rregullsisë së Sistemit Informatik Automatik për Menaxhim me Lëndët Gjyqësore (AKMIS).⁵Në të njëjtën ditë kryetari dhe dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor e vizituan Gjykatën në Gjevgjeli, që të kryejnë mbikëqyrje në procedurën e lëshimit të urdhrin të gjykatëses Zlata Popova me kërkesë të PSP-së që të kryejë kontroll në hapësirat e punës dhe në shtëpinë e ish-kryetarit të Gjykatës Themelore Shkup 1, Vladimir Pançevski. Në një pjesë të mediave dhe opinionit kishte reagime se a kryhet në këtë mënyrë përzjerje në vendimet e Gjykatës Themelore në Gjevgjeli, gjë që është demantuar fuqishëm.⁶

Dorëheqja e u.d. kryetar i Gjykatës Themelore Shkup 1, Stojançe Ribarev

U.d. kryetar i Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, Stojançe Ribarev më 20 tetor 2017 ika dorëzuar Këshillit Gjyqësor lajmërim me shkrim se nga e njëjta ditë ka hapur pushim mjekësor dhe se zëvendëse e tij do të jetë gjykatësja Diana Gruevska Ilievska. Më 25 tetor 2017 gjykatësi Ribarev i ka dërguar Këshillit

⁵http://www.sud.mk/wps/portal/vsrm/sud/vesti/4abad687-abd0-455a-ab42-cd2b6f6ea8e0!/ut/p/z1/rVJdT4MwFP01PJJekY_62C2MOZ2Lsgn0ZSIQtuoobHRM_fWWJxONMDPvU29yPnpuDqloRlSyVmyYEpVko70n1F27gW0DvoN7HD6NgPjg4eUNAFa9FPUBggkg2s9_RhTRTKpabVFSH9OdyNblqwHNMTegriKuJDOg5YOSBtgsZbmLPZOIOzi24zD9si0zy63ULThnmEOnV2ciR8IZ6GgoYPd_-GVix6dDkERbeF8Wi-nEA7LyrxyCH60F0TdsBT-hlawOpT55-McE0x8O30LMnAsdeuXDW_dC-dlQR3QJrcN8PN9oWaa2ppBFheKztDVVvOz3IOiSVVLxN4Xif2IZXa5KfP1uyo_RgxmMU3xaFmWEm0_P7UK1/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F4abad687-abd0-455a-ab42-cd2b6f6ea8e0

⁶http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/0557cfed-7c69-49ba-8c22-cddbe9beaf1d!/ut/p/z1/rVPbUslwEP0aHmMuTZr2EZGLyM3BCs1LJ21SqEjLJVbl6w2OMw6gIIN52p05e_bs2SwUcAxFLstsIk1W5PLZ5qFwI7dJKfLuUMdr3_ioGICncT94wJRTONoFNHHf54B-4PqtBgcCB4rj9Y9QQJHkZmGmMfWxPtbRfFZB6xdVQYsi0SaXFVTqtckqCDHGk1QrwBXPB9SPJfASQkCiVzkz9WMSUqy3diskUDDXGmlHFAEexBhQrF8TYpkqlhMeaOoq7-_IP9W3lo19eFX3VHWGIU_aJUy3ELsehW6HVwL8B_VaDW0Ads6p3T4YtK7LM9CsM8ml1tysdnmmRJdjrDdGA_UYVTrRoNbGOJtkq-jowTRJ1pO9JVDHY4ZcoHnYBdQj6fAt1sHKSbSZ5T7khEYkjNnOD5Aj11o0Ql6if9-9QvsleaPS2XompPqciNfjNw_B-3ZHnJqlvrTqxcaaYgy9MCjv9UupgHc895z8As7dYdGrbLHis31z1go01Hjz4AG2Xe6Q!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F0557cfed-7c69-49ba-8c22-cddbe9beaf1d



Gjyqësor lajmërim me shkrim se jep dorëheqje nga funksioni për arsye private dhe pas shkarkimit të tij do të vazhdojë të kryejë funksionin e gjykatësit në Gjykatën e Lartë.⁷

Paanësia dhe përgjegjësia

Hetim për keqpërdorimi të mundshme në sistemin AKMIS

Më 10 tetor 2017 Kryetari i Komisionit i krijuar nga Ministria e Drejtësisë informoi se është kryer hetim, përkatësisht revizion mbi punën e sistemit AKMIS në Gjykatën Penale Shkup për periudhën 2016 dhe 2017, kur këtë gjykatë e kanë udhëhequr kryetarët Paņevski, Mihajlova dhe Ribarev. Nanev tha se ai dhe anëtarët e Komisionit kanë kontrolluar lëndët e iniciuara nga PSP-ja dhe kanë kryer analizë të shkresave, sepse ekzistojnë dyshime dhe indikacione për mënyrën se si janë shpërndarë lëndët gjyqësore, por edhe është e pamundur që për një ditë të përcaktohet a ka keqpërdorim, dhe për këtë qëllim ata kanë kërkuar aktet të cilat do të dëshmojnë a punon sistemi në mënyrë ligjore. Mbi dyshimet për keqpërdorim të sistemit AKMIS foli, gjithashtu, edhe zëvendësministri i drejtësisë, Oliver Ristovski.⁸

U krye kontroll në zyrat dhe shtëpinë e ish-kryetarit të Gjykatës Themelore Shkup 1, Vlladimir Paņevski nga PSP-ja

Mediat transmetuan se në Gjykatën Themelore Shkup 1 nga ekipi i PSP-së është kryer kontroll në zyrat e ish-kryetarit Vlladimir Paņevski dhe të dy informatikanëve, që ka zgjatur pothuajse pesë orë. Njëkohësisht, mediat transmetuan se ndërkohë është kryer kontroll edhe në shtëpinë e Paņevskit. Jozyrtarisht, hetuesit e PSP-së i kanë marrë të gjitha dokumentet dhe të dhënat e nevojshme nga kompjuteri i tij personal. Sipas prokurores publike speciale, Katica Janeva, bëhet fjalë për procedurë parahetimore ku janë të dyshuar Paņevski dhe dy informatikanë, në lidhje me keqpërdorimin e sistemit kompjuterit gjatë shpërndarjes së lëndëve, por sidomos ato lëndë të PSP-së. Janeva para gazetarëve shprehu dyshim se dhe gjykatësi Paņevski si kryetar i gjykatës u ka dhënë sekrete zyrtare personave të jashtëm.⁹

⁷http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/ba7112bc-4640-414f-b7cc-4dda1b79b3f2!/ut/p/z1/tVJbT8IwFP41e2zarmXtHic6FhSQwJT1hBbB1N2AepQf73lyQgRNGhfmpN8t3PyQQFnUFSyLRbSFHUIV3ZOHDf3epQifovueP_aR0FMSTi-n2LKKHz8CujhEbeAUez5UejGMYHiNP8BCijSyjRmCZNt3WozL58dtH3JHNTUqTaVdFCrt6ZwkJIMY1elgHoUAYppDhRL7ZhlEivmK5K7e7kmLTKYEE1msOMHFzS-ESKN7hINUel8RHCmF5GP843z4--uYFyPLFOUhiLdinxSgKmbW4wZ2Aj91JZDXaQu9gXNWb0l588ssNoiOHgyVCfKHdafiH53_I2YXy_XMntBV3N4PuYGFpVmCosprOPtR1yy1eFqvRWARXfDgvxo4-4sON2VccvlGqverleh1Fd9N89J-b2S1-ADqEk1v/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?uril=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fba7112bc-4640-414f-b7cc-4dda1b79b3f2

⁸<http://www.sudstvo.mk/2017/10/10/%D0%BB%D0%B0%D0%B7%D0%B0%D1%80-%D0%BD%D0%B0%D0%BD%D0%B5%D0%B2-%D0%B8%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D0%B3%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%B0%D0%BA%D0%BC%D0%B8%D1%81-%D1%81%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BC/>

⁹<http://www.sudstvo.mk/2017/10/05/%d0%bf%d0%b0%d0%bd%d1%87%d0%b5%d0%b2%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d1%81%d0%b5-%d1%81%d0%be%d0%bc%d0%bd%d0%b8%d1%87%d0%b8-%d0%b4%d0%b5%d0%ba%d0%b0-%d0%bc%d0%b5%d1%81%d1%82%d0%b5%d0%bb-%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%b4/>



Akti akuzues për “Trista” i plotfuqishëm, janë refuzuar ankesat për mbrojtjen në “Thesar”

Në lidhje me këtë lëndë, Gjykata Themelore Shkup 1 informoi se ka marrë vendim për ankesën dhe se e ka hedhur poshtë si të pabazë me arsyetimin se në pjesën e mësimit juridik thuhet se kundër këtij vendimi nuk lejohet e drejta e ankesës. I akuzuari Popovski ngarkohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit zyrtar kështu që gjatë furnizimit me 300 automjete për MPB-në e ka dëmtuar buxhetin me 450 mijë euro duke u mundësuar disa kompanive që ta fitojnë tenderin edhe pse nuk kanë pasur ofertën më të ulët. Popovski ka kërkuar që bisedat e përgjuara të mos jenë dëshmi kundër tij, kërkesë të cilën këshilli penal i Gjykatës Themelore Shkup 1 e ka pranuar, por pas ankesës të PSP-së Gjykata e Apelit mori vendim me të cilin vendosi që bisedat e përgjuara të mund të zbatohen në procedurën gjyqësore.

Gjykata informoi, gjithashtu, se këshilli për vlerësim të aktit akuzues për lëndën Thesar” të cilin e ka gjykatësi Goran Boshevski, i ka refuzuar ankesat e të tre të akuzuarve në lëndën për furnizim me pajisje për përgjim si të palejueshme.¹⁰

Gjykata Themelore Shkup 1 vazhdon me refuzimin e “bombave” si dëshmi në lëndët e PSP-së

Gjykata Penale në Shkup e informoi opinionin se i ka refuzuar bisedat e përgjuara të cilat i ka dhënë PSP-ja si dëshmi në akuzat për rastet: “Titanik”, “Titanik 2”, “Tank”, “TNT”, “Tifani” dhe “Trevnik”. Edhe përkrah vendimit të Gjykatës së Apelit për pranim të xhirimeve në rastet “Treqind” dhe rastin e njohur si “Shuplaka në Qendër” në shtator, Gjykata Themelore Shkup 1, megjithatë vazhdoi të mos i pranojë bisedat e përgjuara si dëshmi. Refuzimi i dëshmimeve po ndodh në fazën e vlerësimit të akuzave, e cila për pjesën më të madhe të tyre, po zgjat ende.¹¹

Profesionalizëm, ekspertizë dhe efikasitet

Zgjerohet hetimi për përpjekjen për vrasje të deputetit Sela dhe përcaktohet paraburgim për 4 persona

¹⁰http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/1274339b-7cba-4f90-9fb7-7233625db616!/ut/p/z1/rVlJbslwEP2aHC1PVjtHg0lOuuTtpCG-oKzgjjiBGGj5-ppTpVYFKjq3kd4yb_Qwx3PMZboXy1SJRqZrvSfcW3ih4wC9hwc6fe4BC4DQmc8AAoLjc4BwAJif579gjnkuVatWOGI32Vrki_rNgG5XGNA2ealkasc-7JQwwLSiy9t-hkiepcipfEB-IRFELNv2LLfIPNM76bW5KHByFTq-FPBOP_wyDDSfX4Ik2oJ8WUyGAWlsCkyX0SdrwvQP96I84Eg221q_fPrHBMMfDt9CjNwbHc7KT--8G-VHlZqiS2htx_3xUsumaoWErBo8v0pbU8XrZsOZLlkjVfmu8PxfWtbWUU3tDySPvUcU9jN6mFV1TLtP_c2-IQ!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F1274339b-7cba-4f90-9fb7-7233625db616

¹¹http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/7cb42e7a-e159-42d2-88a9-cfd4b7ffdbd6!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6mWPtHgsZQxSjwoT1hXRfUGXdYGVov97yZKJxw-B9u8n5uOfmY15XmCvRyl3QsRiZ_alu2s3cBygd3BP508DYD4QuvAYgE_wsg0QjADzdv4z5pgnSld6i6PqGO9ksi5eLaiPqQVvMWRaCQuarNbSAPLEjp0RgJe300OndqIUuGhJE-dmOR5GqfuWa9KZlqji9DLroDn--GXYWD4vAsSGQvYzTEbjwiw00_1GX20Z8z8sJHZCYeqPBTm5fM_Jhj_cPgWYtK_0qFVfn7rXik_6eqIKaF9mA6nGyMr9BZJId4dZG2ocqX_Z4zU7JS6exN49W_tKwqwoLevCP1MXhAwTCmp0VeLGN9CdFYrkl!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F7cb42e7a-e159-42d2-88a9-cfd4b7ffdbd6



PTHP Shkup informoi se ka miratuar Urdhër për zgjerim të hetimit për përpjekjen për vrasje të deputetit Zijadin Sela edhe për 5 persona të tjerë për veprën e kryer penale Vrasje në përpjekje të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 123 në lidhje me nenin 19 dhe në lidhje me nenin 22 të KP-së.¹²

Pesë personat, me kërkesë të prokurorit publik kompetent janë privuar nga liria gjatë kryerjes së kontrollit në shtëpitë e tyre. Të dyshuarit janë zbuluar me ndihmë të qytetarëve pas shpalljes së fotografive të tyre. PTHP Shkup informon se edhe duke marrë vendim me propozim të prokurorit kompetent publik, gjykatësi në procedurë të mëparshme ka përcaktuar masën paraburgim në afat prej 30 ditësh për katër prej personave të dyshuar. Përveç kësaj, paraburgim në afat prej 30 ditësh është përcaktuar edhe për personin e pestë i cili është privuar më parë nga liria për të njëjtën ngjarje dhe për të cilin vendimi i gjykatës është shtyrë për shkak të gjendjes shëndetësore të përkeqësuar të të dyshuarit.¹³

U formua Komision i Përkohshëm PPRM për veprim për parregullsitë zgjedhore

PPRM-ja e informoi publikun se në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve lokale më 15 tetor 2017, ka formuar Komision të përkohshëm për ndjekje të parregullsive eventuale në zgjedhje, lidhur me veprat penale kundër zgjedhjeve dhe votimit në kapitullin 16 të Kodit Penal, si dhe të veprave të tjera penale të cilat janë kryer gjatë organizimit dhe zbatimit të zgjedhjeve. Si kryetar i saj është caktuar Xhelal Bajrami, prokuror publik në PPRM.¹⁴ Komisioni ka mbajtur takim konsultativ me përfaqësues të organizatave qytetare të cilat e ndjekin procesin zgjedhor, të cilave Bajrami u bëri apel se nëse kanë informacione për shkelje të dërgojnë informacionet në këtë Komision.¹⁵

Pas përfundimit të ditës së parë të zgjedhjeve, Komisioni informoi se PPRM-ja vepron për gjashtë raste juridike-penale (një në PTHP Manastir, dy në PTHP Koçani dhe tre në PTHP Shkup), për arsye se është vërtetuar ekzistimi i dyshimit me bazë se janë kryer vepra penale Mito gjatë zgjedhjeve dhe votimit dhe Mashtrim zgjedhor. Ekzistojnë procedura parahetimore edhe për shtatë raste juridike-penale për të cilat prokuroritë publike kanë marrë informacione nga MPB-ja, qytetarët apo institucionet e tjera kompetente. Bëhet fjalë për raste të cilat kanë ndodhur në territorin e PTHP Manastir, Ohër, Strugë, Shkup dhe Koçan lidhur me veprat Shkelje e lirisë së përcaktimit të zgjedhësve, Mito gjatë zgjedhjeve dhe votimit dhe Mbjajtje e kundërligjshme me mjete të buxhetit gjatë zgjedhjeve. Bajrami shtoi se në adresën e tyre elektronike kanë arritur shumë fletëparaqitje të dhënat e të cilave do të shqyrtohen.¹⁶ Pas përfundimit të procesit zgjedhor me rrethin e dytë zgjedhor, pritet që Komisioni të dalë me informacione të reja për rrjedhën e procedurave dhe për procedurat e reja parahetimore dhe hetimore të hapura eventualisht.

¹²<http://jorm.gov.mk/?p=4348>

¹³<http://jorm.gov.mk/?p=4368>

¹⁴<http://jorm.gov.mk/?p=4300>

¹⁵<http://jorm.gov.mk/?p=4321>

¹⁶<http://jorm.gov.mk/?p=4336>



II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Të ikurit Grujevski dhe Boshkoski u arrestuan në aeroportin e Selanikut

Policia greke vërtetoi se në aeroportin e Selanikut me pasaporta bullgare të falsifikuara i ka arrestuar ish të punësuarit në DSK, Goran Grujevkin dhe Nikolla Boshkoskin,¹⁷ të cilët nga 18 korriku 2017, kur Gjykata e Apelit Shkup u shqiptoi masë paraburgimi nuk ishin në dispozicion të policisë maqedonase. Që atëherë policia ata i ka kërkuar me urdhër arresti ndërkombëtar për akuzat lidhur me përgjimin jolegal apo më konkretisht, në lidhje me lëndën “Tvrdina-Target”, që lidhet me ndjekjen e jashtëligjshme të komunikimeve nëpërmjet keqpërdorimit të sistemeve të MPB-së dhe për shkatërrimin fizik të një pjese të pajisjes me të cilën është kryer kjo vepër penale. Grujevski është i akuzuari i parë në lëndën “Tvrdina 2” ku Gjykata Themelore Shkup 1 para pak kohe e dënoi me 1 vit e 6 muaj burg për veprën Falsifikim të dokumentit zyrtar dhe e shpalli fajtor për shkatërrimin e dëshmimeve të cilat do të shërbenin në procedurat e lëndës “Tvrdina – Target”.

U pranuan aktakuzat për rastet “Total” dhe “Trust”

Gjykata Themelore Shkup 1 informoi se gjykatësi për vlerësim të aktakuzës ka marrë vendim me të cilin aktakuzat të cilat PSP-ja i ka dhënë për rastet “Total” dhe “Trust” i ka miratuar dhe si rrjedhim i kësaj janë formuar lëndët të cilat nëpërmjet sistemit AKMIS u janë shpërndarë gjykatësve për gjykim të mëtejshëm.

Në rastin “Total” i dyshuar është gazetari Dragan Pavloviq Llatas se si pronar i kompanive të marketingut dhe shërbimeve konsultuese “Total”, “Media MAK”, “Total marketing” dhe “Media centar” në periudhën 2008-2015 ka anashkaluar pagimin e tatimit në vlerë prej rreth 180 mijë eurosh.

Në rastin “Trust” janë akuzuar drejtorët e kompanive “Transmet”, “Sileks nemetali” dhe “Bato” për dhënien e informacioneve të rreme gjatë pjesëmarrjes në tender për nxjerrje të jallovina, kështu të akuzuarit kanë marrë pronë në mënyrë të paligjshme e cila kap shumën prej 17,235 milionë eurosh.¹⁸

¹⁷<http://www.telma.mk/vesti/grujovski-i-boshkovski-uapseni-vo-solun>

¹⁸http://www.sud.mk/wps/portal/osskopje1/sud/vesti/7cb42e7a-e159-42d2-88a9-cfd4b7ffdbd6/!ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6mWPtHgsZQxSJwoT1hXRfUGXdYGVov97yZKJxw-B9u8n5uOfmY15XmCvRyl3QsIRiZ_alu2s3cBygd3BP508DYD4QuvAYgE_wsg0QjADzdV4z5pgnSld6i6PqGO9ksi5eLaiPqQVvWRaCQuarNbSAPLEjP0RgJJe300OndqIUuGhJE-dmOR5GqfuWa9KZlqji9DLroDn--GXYWD4vAsSGQvyZTEbjwiw00_1GX20Z8z8sJHZCYeqPBTm5fM_Jhj_cPgWYtK_0qFVfn7rXik_6eqIKaF9mA6nGyMr9BZJIz4dZG2ocqX_Z4zU7JS6exN49W_tKwqwoLevCP1MXhAwTCmp0VeLGn9CdFYrki!/dz/d5/L2dBISevZ0FBIS9nQSEh/?uril=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F7cb42e7a-e159-42d2-88a9-cfd4b7ffdbd6



Aktivite te Komisionit Shtetëror për Ndalim të Korrupsionit (KSHNK)

Në takim qe u mbajt më 16 tetor 2017 kryetari i KSHNK-së, dr. Igor Tanturovski dhe dy anëtarë të tjerë të Komisionit, dhe përfaqësues të Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Transparensi Interneshënëll – Makedonija (TIM) dhe të Institutit për Demokraci Societas Civilis biseduan mbi projektin “Përforcimi i Platformës së organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit”, ku morën pjesë 15 organizata qytetare, dhe aktivitetet të cilat dolën nga bashkëpunimi i përbashkët, si dhe për nevojat për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Ndalim të Korrupsionit, Ligjit për Ndalim të Përplasjes së Interesave dhe Ligjit për Lobim. Këto ligje duhet të harmonizohen në mënyrë të tillë që të mundësohet zbatim efikas i reformave kundër korrupsionit në shtet. Të pranishmit ranë dakord se nëpërmjet bashkëpunimit të përbashkët dhe nëpërmjet mbështetjes, shkëmbimit të përvojave, njohurive dhe ekspertizës në ndjekjen dhe analizimin e politikave dhe aktiviteteve aktuale publike për shkatërrim të korrupsionit do të kontribuohet në zmadhimin e kapaciteteve të institucioneve dhe në vetëdijen e qytetarëve për luftën kundër korrupsionit.¹⁹

Përfaqësuesit e KSHNK-së mandej realizuan takim pune me znj. Sllagjana Taseva, kryetare e TIM-it, ku u bë fjalë mbi Ligjin për Mbrojtje të Denoncuesve, përcaktimi i dobësive në zgjidhjet e sistemit, si dhe bashkëpunimi dhe aktivitetet e përbashkëta në drejtim të zmadhimit të vetëdijes publike së qytetarëve për të vepruar në bazë të këtij ligji, informimi i publikut mbi të drejtat dhe obligimet të cilat dalin prej tij, si dhe mbrojtja efikase e denoncuesve.²⁰

Në fund, mendimet e KSHNK-së në lidhje me zgjedhjen dhe shkarkimin e gjykatësve janë shqyrtuar nga Këshilli Gjyqësor në suazat e mbledhjes së tij të 264 të mbajtur më 4.10.2017.²¹

¹⁹https://www.dksk.mk/index.php?id=34&tx_news_pi1%5Bnews%5D=345&tx_news_pi1%5Bcontroller%5D=News&tx_news_pi1%5Baction%5D=detail&cHash=54550184ee88f617f4f82e6e046649b0

²⁰https://www.dksk.mk/index.php?id=34&tx_news_pi1%5Bnews%5D=344&tx_news_pi1%5Bcontroller%5D=News&tx_news_pi1%5Baction%5D=detail&cHash=2200c73c870d6abf1cc6caf06eb81674

²¹http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/2e4ff935-ac97-45d8-af8a-75bd45958143!/ut/p/z1/rVNNU9swFPwtHHyUJVuSjFVmoCFNmwsGusS6eGRHdlzwB7awob--CsNMJ4EmZahub2bfvn37VIDCFZS1GspCmbKp1Z2tYxkkwQUhiH9F3_jsXKAwInhydfndI4zAm13AhbfkFrCMAjGd-FGEoTzc_wNKKLPatGYD474ZtEmqWwf1D2sHtU2mTa0cNOielA7yNclzSIQmWCA0DUHKucKMJquCRWUewRv6dqsXMOYoyCjMARA-AxbNGcgFSwFQuGACIYoU3pft9W_noLy9EL_0HAPKYffLYCLnL8drhGZRIWrljVrnI5R6m2OcbJT7hLPC2FwzrFPMCyk7nutOd-9DZw26MaftPDnLQOISu0TTFnXazpnLQWYy2bpjdwtyuEsV2e_VG2nE6YVfbZoyG_8q-n1p2h1COM6qarbJau33kbS7A3Yc-iffWhJuzeXL5Bcbetqj75CBB8oxWhXYxwcyjKAAcewGw3uVAUJaB3POVoIQJRX0Y--c4fACC_pBi47Qsw_Sz47F1yal_HI_L0P7h5va6Ecbkv_xiS2v383P5jaBrTibUNZ5A1f_1NpWUcXxUwlu87mhKS2q5Px0QYcFiGfDr9MFkOnTGJ6c_AbCDcx3/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?uril=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F2e4ff935-ac97-45d8-af8a-75bd45958143



Punëtori mbi Analizën e autorizimeve diskrecionale të mbartësve të funksioneve publike

Në periudhën nga 18 deri më 20 tetor 2017, grupi punues për zbatimin e Analizës së autorizimeve diskrecionale të mbartësve të funksioneve publike, mbajti punëtori ku u shqyrtuan raportet për vetëvlerësim që u janë dorëzuar organeve dhe institucioneve. Raportet përmbajnë pyetësorë me përgjigje të detajuara mbi autorizimet diskrecionale të përcaktuara në ligjet e veçantë, kurse janë bazë për vlerësimin e përgjithshëm të tyre në sistem. Analiza duhet të japë rekomandim për reduktim të tyre, përkatësisht për shqyrtim të zgjidhjeve të mundshme për reduktim të autorizimeve diskrecionale të konstatuara dhe propozimeve për ndryshim dhe plotësim të ligjeve dhe akteve nënligjore.²²

Gjetjet e prezantuar nga analizat e lëndëve penale “Otpad” (Bërlloku) dhe “Muzei na Makedonija” (Muzetë e Maqedonisë)

TIM në bashkëpunim me “Zelena Lupa” (Lupa e Gjelbër) mbajti konferencë për shtyp ku u prezantuan gjetjet e analizave për veprat penale “Otpad” (Bërlloku) dhe “Muzei na Makedonija” (Muzetë e Maqedonisë) të përgatitur nga ekspertët në suazat e Projektit “Të gjithë së bashku në rrugën për drejtësi” i mbështetur nga Programi “Civica Mobilitas”. Në pesën hyrëse në këtë konferencë për shtypu tha se qytetarët i janë drejtuar këtij trupi që t’i shqyrtojnë veprimet e organeve kompetente me qëllim që të vlerësohet se a janë respektuar ligjet dhe se a janë udhëhequr organet kompetente në përputhje me parimet e përcaktuara në ligje. Në këto analiza janë konstatuar parregullsi në procedura, këto parregullsi lidhen me faktin se gjykata nuk ka siguruar dëshmi të mjaftueshme apo nuk ka pasur bazë që të përcaktohet ekzistimi i veprës penale, si dhe një sërë parregullsish të tjera.²³

PROCEDURA GJYQËSORE AKTUALE

LËNDA “Sopo” (KOK nr. 53/10): Në seancën e mbajtur më 18.10.2017, gjykata ua tha gjashtë të akuzuarve në këtë proces të drejtat e tyre në procedurë, dhe pas pyetjes së bërë nga gjykata të akuzuarit mbetën në deklaratat e veta të dhëna në procedurën e mëparshme. Para fillimit të procedurës dëshmuuese përfaqësuesi i akuzës propozoi dëshmi të reja, materiale dhe verbale, dhe kërkoi nga gjykata dëgjimi i dëshmitarëve të kryhet pas nxjerrjes së dëshmime materiale të cilat janë relevante për dëshmitë e dëshmitarëve. Në lidhje me dëshmitë e reja të propozuara, mbrojtja kërkoi kohë nga gjykata me qëllim që të njihet me to, kurse mandej dha deklaratë për to. Seanca u shty për më 23.11. 2017.

LËNDA “E Majta” (K. nr. 986/16): Me ndryshim të gjykatat gjykues në këtë procedurë, seanca për këtë lëndë filloi nga fillimi. Gjatë thënies së përmbajtjes të propozimit akuzues, prokurori publik i cili mbeti me të njëjtin propozim akuzues, bëri plotësim në lidhje me listën e dëshmime dhe në seancë dorëzoi në gjykatë dhe te palët në procedurë mendim dhe gjetje të reja nga eksperti. Duke pasur parasysh se

²²https://www.dksk.mk/index.php?id=34&tx_news_pi1%5Bnews%5D=346&tx_news_pi1%5Bcontroller%5D=News&tx_news_pi1%5Baction%5D=detail&cHash=034f30763359fe55a7e27bd8f5f9c033

²³<http://transparency.org.mk/>



palëve u nevojitet kohë që të shqyrtojnë dëshminë e re dhe të japin deklaratë për të, seanca u shty për më 05.12.2017.

LËNDA “Dhuna në Kuvend” (K. nr.1330/17): Më 12.10.2017 në Gjykatën Themelore Shkup 1 është shpallur dhe arsyetuar aktvendimi kundër të akuzuarit P. Arsov, i akuzuar për veprën penale Dhunë ku e si të dëmtuar ishin Radmilla Sheqerinska dhe Zoran Zaev, atëherë deputetë, ku njëri ka marrë lëndim të rëndë trupor, kurse tjetri lëndim trupor. I akuzuari është dënuar me dënim me burg prej 4 vjetësh, ku llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpie. Më parë, në seancën e mbajtur më 06.10.2017 i akuzuari vullnetarisht dhe me vetëdije e pranoi fajin dhe e pranoi në tërësi aktakuzën. Fjalë përfundimtare thanë prokurori publik i cili i tha rrethanat lehtësuese dhe vështirësuese dhe kërkoi nga gjykata që ta dënojë përkatësisht kryerësin e veprës. I autorizuari i të dëmtuarve iu bashkëngjiti fjalës përfunduese të prokurorit publik dhe kërkoi nga gjykata t’i drejtojë në çështje gjyqësore për kërkesë juridike-pronësore kundër të akuzuarit. Mbrojtësi dhe i akuzuari thanë fjalët përfundimtare ku kërkuan nga gjykata një dënim më të lehtë, kurse i akuzuari i kërkoi falje të dëmtuarës para gjykatës dhe të gjithë opinionit për veprën penale të kryer.

LËNDA “Tvrdina 2” (K. nr. 1905/16): Më 02.10.2017 në Gjykatën Themelore Shkup q vazhdoi procesi për rasti “Tvrdina 2” (Kështjella 2) ku për shkatërrimin e 20 mijë regjistrimeve lidhur përgjimin masiv, në mungesë gjykohet i akuzuari, ish-shefi i Drejtorisë së Pestë në MPB, i cili është në arrati. I akuzuari i parë në këtë rast është ish-shefi i Drejtorisë për Sigurim dhe Kundërzbulim, si dhe gjashtë të punësuar në këtë Drejtori. Dëshmitarët në rastin “Tvrdina 2” pohuan se komisioni i Drejtorisë së pestë në bazën sekretë të quajtur “Brest” në fshatin Petrovec, Shkup i kanë shkatërruar materialet të cilat ishin nga DSK-ja. Për përmbajtjen e materialeve të shkatërruara, të cilat ishin vendosur në qese të zeza, dëshmitarët theksuan se nuk dinin se për se bëhej fjalë. Opinioni disa herë është përjashtuar nga gjykimi sepse para gjykatës janë nxjerrë dokumente të klasifikuara të DSK-së. Me kërkesë të mbrojtjes dhe të PSP-së për plotësim të dëshmive, gjykimi është shtyrë për më 06.11.2017.

Lënda “Bozhinovski” (KOK. nr. 79/16): Seanca më 16.10.2017 filloi me vonesë prej pothuajse një ore. Menjëherë pas fillimit të seancës mbrojtësi i të akuzuarit kërkoi që të shtyhet seanca për arsye se dëshmitë të cilat i kërkuan më parë (aktvendimet e lëndës “Spiun”) u janë dorëzuar më vonë, ndërsa bëhet fjalë për një material të madh. Seanca u shty për më 16.11. në orën 10:00.

SEANCA TË SHTYRA: Në lëndën “Pavle” (K. nr. 1526/16), seanca e 10.10.2017 u shty për më 06.11.2017 në orën 11:00; në lëndën “Mariglen” (K. nr. 1271/16) seanca e 10.10.2017 u shty për më 09.11.2017 në orën 12:30 për shkak të nevojës për mbledhje të dëshmive origjinale nga PTH-ja, kurse në lëndën “Lagjja e trimave” (KOK. nr. 127/15) Gjykata Themelore Shkup 1 shpalli se seanca për shpalljen e vendimeve shtyhet për më 02.11.2017 me kërkesë të MPB – Byrosë për Siguri Publike.²⁴

²⁴<http://sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti>



III TË DREJTA THEMELORE

Avokati i Popullit

Gjatë fushatës për zgjedhjet lokale, Avokati i Popullit e theksoi edhe njëherë rëndësinë e respektimit të të drejtës së shprehjes së lirë të vullnetit të qytetarëve si një prej të drejtave fundamentale të qytetarëve, në çdo shoqëri demokratike. Në lidhje me këtë ai u bëri thirrje organeve kompetente, në suazat e mundësive dhe kompetencave të tyre të kontribuojnë për zbatimin e zgjedhjeve ku votimi do të jetë i lirë dhe pa pengesa, në përputhje me ligjin dhe se do të respektohen të drejtat e njeriut.²⁵

Të shtatë zyrat e Avokatit të Popullit ishin të hapura për qytetarët ditën e mbajtjes së të dy rathëve zgjedhorë me qëllim që t'i ndihmojë në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Edhe pse KSHZ-ja informoi se gjatë votimit të të sëmurëve, të pafuqishmëve, personave të shpërngul si edhe të të burgosurve në institucionet ndëshkimore edukuese, gjithçka ka kaluar pa probleme dhe nuk janë regjistruar incidente, nga zyrat e Avokatit të Popullit ishte konstatuar se 400 të burgosur nuk kishin mundësi ta realizojnë të drejtën e tyre të votës sepse nuk kanë qenë në Listën e zgjedhjeve, për arsye se një pjesë e të burgosurve nuk kishin dokumente të vlefshme për identifikim. Z. Memeti theksoi se prej 1.810 në burgun më të madh "Idrizovë", në Listën zgjedhore janë regjistruar gjysma (955 të burgosur) prej të cilëve në votim në rrethin e parë kanë dalë 696, ku 273 janë kthyer, sepse nuk kishin letërnjoftim të vlefshëm, prandaj vetëm 423 të burgosur e realizuan të drejtën e tyre të votë. Përndryshe, edhe para votimeve është treguar për këtë gjendje, kurse drejtorisë së burgut i është bërë thirrje që të organizojë ekip mobil nga MPB-ja që të vijë në burg dhe t'i fotografojë personat e dënuar të cilët kanë letërnjoftime me afat të kaluar në një ditë, por nuk ka pasur reagim pozitiv nga kompetentët.²⁶

Nga zyra e Avokatit të Popullit reagan dhe për lëshimin e letërnjoftimeve në një ditë para si dhe në vetë ditën e mbajtjes së zgjedhjeve. Ata theksuan së kjo praktikë është absurde sepse lista zgjedhore është mbyllur më 9 shtator dhe se të gjithë qytetarët të cilët u ka kaluar afati i dokumenteve pas kësaj date, janë fshirë nga lista.²⁷

Liria e shprehjes dhe pluralizmi në media

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale vazhdoi me monitorimin e prezantimit zgjedhor në media, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor që zbatohen gjatë fushatës zgjedhore. Në raportin e Agjencisë thuhet se shërbimet programore në nivel shtetëror, në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale kanë siguruar në përgjithësi kushte të barabarta për qasje të gjitha format e përfaqësimit medial të zgjedhjeve, kurse një pjesë e madhe e tyre bënë përpjekje që të realizojnë ballafaqime në debat të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Njëkohësisht vihet re se një pjesë e

²⁵http://ombudsman.mk/mk/novosti_i_nastani/241429/soopshtenie_po_povod_prestojnite_lokalnite_izbori_2017.aspx

²⁶<https://sdk.mk/index.php/makedonija/273-zatvorenitsi-vrateni-od-glasane-oti-im-istekle-lichnite-karti/>

²⁷<http://telma.mk/vesti/apsurd-e-izdavanjeto-na-lichni-karti-deneska-i-utre>



kandidatëve kanë marrë pjesë në emisionet e veçanta informative te disa media, kurse po të njëjtit ata nuk u janë përgjigjur ftesave të mediave të tjera.²⁸

Në bazë të monitorimit të kryer, Agjencia ngriti procedura shkelës kundër TV Alfës (sepse nuk ka siguruar mbulim të balancuar të zgjedhjeve lokale në dhjetë ditët e para të fushatës zgjedhore), si edhe kundër TV Kompanive 21-M dhe TV Star (për shkak të emetimit të reklamimit të paguar politik në programe të veçanta informative). Gjatë heshtjes zgjedhore për rrethin e dytë të votimit në zgjedhjet lokale 2017, është konstatuar një shkelje te shërbimi i programit të parë të Radio Maqedonisë (Radio Shkupi). Përveç kësaj, dy ditët e fundit të monitorimit të fushatës zgjedhore në rrethin e dytë të zgjedhjeve, është konstatuar edhe shkelje e limiteve për reklamim të paguar politik te TV Nova. Agjencia paralajmëroi se do të ngrëjë kërkesë te gjykata kompetente për ngritje të procedurave shkelëse.²⁹

Diskriminimi

Nga tre radiodifuzerë në shtet është emetuar fushatë e cila ka pasur përmbajtje diskriminuese dhe shpërhapje të mizogjinisë dhe seksizmit, duke e shkelur kështu Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audivizuale. Në fushatë, nëpërmjet diskriminimit në bazë të gjinisë, emancipimi i grave është prezantuar si dukuri negative, kurse gratë e suksesshme janë pasqyruar në përbuzje dhe urrejtje nëpërmjet prezantimit të emancipimit dhe suksesit profesional të gruas si veti negative.

Gjatë fushatës parazgjedhore është regjistruar edhe rast i gjuhës së urrejtjes i cili nënvlerëson dhe me këtë e nxitet urrejtja ndaj një grupi të marginalizuar. Domethënë, në një miting kandidati për kryetar komune dhe kryetari i deritanishëm i Komunës së Karposhit, Stevço Jakimovski, në fjalimin e tij përdori një sërë fjalësh ofenduese dhe degraduese me qëllim që të “sulmohet” kundër kandidati, duke thënë se për të flitet se është homoseksual. Gjatë kësaj, ai homoseksualët i quajti “mafia më e rrezikshme”, “mafia e cila dëshiron të instalohet në Komunën e Karposhit”. Fjalimi i tillë është vepër penale “Nxitje e urrejtjes, përçarjes apo mostolerancës në bazë gjinore, nacionale, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese”, në përputhje me nenin 319 të KP-së. Atij i ka paraprirë një propagandë ekstensive kundër njerëzve me orientim të ndryshëm seksual e vërejtur në materialet e botuara nëpër komunë me përmbajtje ofenduese dhe shqetësuese ndaj bashkësisë LGBTI.³⁰

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Koalicioni DSSHGM e gjykuan këtë ngjarje dhe dorëzuan fletëparaqitje penale në PTHP për kryerje të veprës penale të paraparë në neni 319 të KP-së, për të cilën është paraparë dënim me burg nga një deri në pesë vjet burg dhe i bënë thirrje Prokurorisë që të

²⁸<http://avmu.mk/%D1%80%D0%B0%D0%B4%D0%B8%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%84%D1%83%D0%B7%D0%B5%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BE%D0%B1%D0%B5%D0%B7%D0%B1%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%B8/>

²⁹<http://avmu.mk/%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B8%D1%80%D0%B0%D0%BD%D0%B8-%D0%B4%D0%B2%D0%B5-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%BA%D1%80%D1%88%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B0-%D0%BD%D0%B0/>

³⁰<http://mhc.org.mk/announcements/650?locale=mk#.WgTQZtCnHIU>



zbatojë procedurë të shpejtë dhe efikase për përcaktim të përgjegjësisë së kryerësit, kurse gjykata të shqiptojë masën përkatëse me të cilën do të veprohet në mënyrë parandaluese mbi shpërhapjen e mëtejshme të gjuhës së urrejtjes.

E drejta e privatësisë

Në suazat e projektit “Rrjeta 23” është promovuar studimi për politikën publike “Kah panoptikonit – Ekuilibri i mirë midis mbrojtjes së privatësisë dhe nevojës së ndjekjes së komunikimeve” i përgatitur nga shoqata “Zhenska akcija”.³¹ Ky studim jep pasqyrim të gjendjes duke u nisur nga shkeljet masive të të drejtave të njeriut dhe prishjes së privatësisë, mbrojtjes së të dhënave personale dhe lirisë së shprehjes të konstatuara me shpalljen e “bombave” politike në vitin 2015 nëpërmjet të cilave është zbardhur ndjekja jolegale e komunikimeve telefonike të elitave politike dhe biznes elitave, mediave dhe aktivistëve qytetarë.

Studimi propozon masa përkatëse për parandalim të keqpërdorimeve të sistemeve për ndjekje të komunikimeve, dhe me të: të rikontrollohet arsyetimi i lejimit të ndjekjes së komunikimeve për një spektër kaq të gjerë të veprave penale, në bazë të vlerësimit se a është shkelja e privatësisë në proporcionalitet me peshën e veprës për të cilën bëhet fjalë dhe dëshmitë që priten të mblidhen me masat e veçanta hetimore; të mundësohet qasje e drejtpërdrejtë në përmbajtjen e komunikimeve nga nëpunësit pa e informuar paraprakisht operatorin dhe t’i lëshojnë urdhër gjykate për ndjekje; të vendose edhe një anë në procedurë për miratim të ndjekjes së komunikimeve që do t’i përfaqësojë interesat e personave komunikimet e të cilëve propozohet që të ndiqen (p.sh. panel ekspertësh, përfaqësues nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale apo nga Avokati i Popullit); të veçohen me ligj kompetencat dhe dispozitat për ndjekje të komunikimeve gjatë hetimeve penale, prej atyre me karakter sigurie dhe kundërzbulimi; si dhe të vendoset dhe komision qytetar për mbikëqyrje dhe ndjekje të komunikimeve, të cilin do ta emërojë Kuvendi, i përbërë nga ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë qytetare. Ministri për shoqëri informatike dhe administratë Damjan Maņevski mori obligim se do t’i përfshijë rekomandimet në ndryshimet ligjore për ndjekje të komunikimeve.³²

Institucione të mbyllura

Komiteti për Parandalim të Torturës (KPT) i Këshillit të Evropës në raportin e shpallur më 12 tetor 2017, gjetjet e të cilit dolën nga vizita në RM në dhjetor të vitit 2016, shpreh kritikë mbi mënyrën se si trajtohen personat e burgosur në shtet. Në këtë raport thuhet se kushtet e burgut të para në Idrizovë mund të konsiderohen si çnjerëzore, duke marrë parasysh sidomos edhe nivelin e ulët të mbrojtjes shëndetësore e cila u sigurohet të burgosurve, që nuk është mbrojtje përkatëse dhe i vë në rrezik jetë e tyre, por vihet re, gjithashtu, edhe problemi i keqtrajtimit të të burgosurve dhe i dhunës mbi ta, si edhe mungesa e aktiviteteve dhe mungesa e kuadrit në burg dhe trajnimi i tyre i pamjaftueshëm. Në raport

³¹http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Kon-gragjanski-panoptikon-ramnoteza-pomegiu-sledenje-na-komunikaciite-i-privatnosta_MK.pdf

³²<http://www.merc.org.mk/aktivnost/31/potrebna-e-ramnotezha-pomegiu-privatnosta-i-potrebata-za-sledenje-na-komunikaciite-istrzhuvanje>



përshkruhet, gjithashtu, edhe fakti se është vënë re prania e madhe e korrupsionit në sistemin e burgut në çdo aspekt (vendosja në qelinë përkatëse apo leja për mungesë, qasja te mjekimet, telefoni celular apo përdorimi i drogës).

Që në vitin 2006 KPT-ja disa herë i ka theksuar problemet fundamentale strukturore, mungesën e politikës së menaxhimit, procedurave jopërkatëse për paraqitje dhe sistemit për ndjekje dhe mungesën menaxhimit me personelin dhe pamundësia që personeli i burgut të kryejë detyrat e veta. Gjetjet e raportit tregojnë se është arritur një përparim i vogël në ballafaqimin me problemet në sistemin ndëshkues-korrigjues, KPT-ja e përmbyll raportin e vet me konstatimin se “është koha që sundimi i të drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut të zbatohen krejtësisht në sistemin e burgut” dhe Republika e Maqedonisë “t’i përmbushë obligimet ndërkombëtare dhe të bashkëpunojë me KPT-në”.³³

Krim nga urrejtja

Gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale, si dhe gjatë mbajtjes së rrethit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve, është vënë re, përsëri, rritja e numrit të incidenteve nga urrejtja. Gjatë muajit tetor, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar tetëmbëdhjetë vepra penale nga urrejtja. Katërmëdhjetë prej tyre, përkatësisht, pothuajse 80, për qind të numrit të përgjithshëm të incidenteve të regjistruara në tetor janë kryer për shkak të përkatësisë politike apo bindjes politike.³⁴

Praktika e dëmtimit të shtabeve të partive ka vazhduar, kështu që dhjetë nga incidentet kanë përfshirë demolimin e shtabeve partiake të gjashtë partive politike (katër të VMRO DPMNE-së, dy të BDI-së, një të LSDM-së, një të Bashkuar për Maqedoninë, një të GROM-it dhe një i BESËS). Përveç kësaj, gjatë fushatës zgjedhore janë vërejtur edhe incidente të cilat përfshijnë dhunë fizike, kurse gjatë sulmeve fizike është lënduar kandidati për kryetar komune i Komunës Shuto Orizari. Mbrëmjen e 15 tetorit një person me thikë e ka kërcënuar kandidatin për kryetar komune për Komunën e Karposhit dhe qytetarët e mbledhur para shtabit partiak, kurse në Sveti Nikollë një çift është sulmuar dhe lënduar fizikisht menjëherë pas festimit të LSDM-së në qendër të qytetit.

³³<http://www.libertas.mk/kpt-na-sovetot-na-evropa-konstatira-loshi-uslovi-vo-makedonskite-zatvori/>

³⁴<http://www.zlostorstvaodomraza.mk/>